



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MISIONI NË KOSOVË

Departamenti për Monitorim

Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik

Raport Mujor - Maj 2008

Numri i lëndëve të pakryera civile në gjykatat e Kosovës ndikon në të drejtën për gjykim brenda kohës së arsyeshme

1) Përmbledhje

Standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut parashohin se çdokush ka të drejtë për dëgjim korrekt brenda kohës së arsyeshme.¹ Kjo garanci nënvizon “rëndësinë e ndarjes së drejtësisë pa vonesa të cilat do të mund të vënë në rrezik efikasitetin e besueshmërinë e saj”.² Andaj, Shtetet janë të obliguara t’i organizojnë sistemet e tyre të drejtësisë në atë mënyrë që t’i lejojnë gjykatat të punojnë në pajtim me këtë të drejtë.³ Në linjë me këto standarde, Ligji mbi Procedurën Kontestimore parasheh që gjykata do t’i zhvillojë procedurat civile pa ndonjë vonesë të panevojshme.⁴

Në fund të vitit 2007, ka pasur 49,220 lëndë civile të pakryera⁵ pranë gjykatave komunale në Kosovë. Në fillim të vitit 2007, kanë qenë 46,551 raste të pakryera pranë gjykatave komunale. Gjykatat, gjatë vitit kanë pranuar 13,401 lëndë dhe gjyqtarët kanë zgjidhur 10,526 raste në vitin 2007. Rrjedhimisht, gjykatat komunale nuk ishin në gjendje të zgjidhin ngarkesën e lëndëve që kanë pranuar gjatë vitit 2007.⁶ Situatë e njëjtë me të dhëna të ngjashme ka ndodhur në vitin 2006.⁷ Prandaj, shqetësuese është se për çdo vit i shtohen më shumë lëndë numrit prej afro 50,000 lëndëve të pakryera civile që ndodhen në pritje nga vitet e kaluara. Disa nga këto lëndë janë në pritje për kohë më të gjatë se sa afati i pranueshëm kohor ndërmjet inicimit të procedurës dhe vendimit final për kontestin.

¹ Neni 6(1) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“Konventa”). Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka gjetur se arsyetimi i kohëzgjatjes së procedurës varet nga rrethanat e veçanta të rastit, përfshirë këtu edhe ndërlikimet rreth rastit, sjellja e të pandehurit si dhe sjellja e autoriteteve kompetente administrative dhe gjyqësore. Shih Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Konig kundër Gjermanisë*, aplikacioni nr. 6232, aktgjykimi, 28 qershor 1978, paragrafi 99.

² Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *H kundër Francës*, aplikacioni nr. 10073/82, aktgjykimi, 24 tetor 1989, paragrafi 58.

³ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Muti kundër Italisë*, aplikacioni nr. 14146/88, aktgjykimi, 23 mars 1994, paragrafi 15.

⁴ Neni 10 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë Nr. 4/77, 1478, 36/80-1182, 69/82-1596.

⁵ Gjatë monitorimit të drejtpërdrejtë të sistemit të drejtësisë civile në Kosovë, OSBE nuk ka vërejtur ndonjë qëllim për të shkaktuar vonesa të tepruara në ndonjë komunitet të veçantë në Kosovë. Po ashtu nuk është e qartë se a kanë vonesat e përgjithshme në ndonjë më shumë ndikim në një grup etnik se sa në një tjetër.

⁶ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Raport Statistikor mbi Punën e Gjykatave të Rregullta 2007. Në gjykatat e qarkut numri i lëndëve të pakryera është më pak serioz. Gjykatat e qarkut, kanë pasur në shkallë të parë 939 raste civile të pakryera në fillim të vitit 2007. Gjatë vitit 2007, gjykatat e qarkut të shkallës së parë kanë pranuar 2,320 lëndë civile, kanë zgjidhur 2,205 lëndë civile, dhe 1,054 lëndë të pakryera në fund të vitit 2007. Në shkallën e dytë, gjykatat e qarkut kanë arritur të zgjidhin më shumë lëndë civile (3,449) se sa numri i pranuar i lëndëve (3,120), duke rezultuar në 2,980 raste të pakryera në fund të vitit 2007. Diku dy të tretat e të gjithë numrit të lëndëve civile janë konteste që kanë të bëjnë me pronën, shih *Raportin e Sekretarit të Përgjithshëm mbi Administratën e Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë*, S/2006/906, 20 nëntor 2006.

⁷ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Raport Statistikor mbi Punën e Gjykatave të Rregullta 2006: Në fund të vitit, ka pasur rreth 46,551 lëndë të pazgjidhura civile që ndodheshin pranë gjykatave komunale në Kosovë. Në fillim të vitit 2006, ka pasur 42,744 lëndë të pakryera në gjykatat komunale. Gjykatat gjatë vitit kanë pranuar 13,245 lëndë, dhe gjyqtarët kanë zgjidhur 9,400 raste në vitin 2006.

Ka shumë faktorë që i kontribuojnë vonesave në rastet civile. Kjo përfshin menaxhimin e dobët të lëndëve nga ana e gjyqtarëve dhe personelit ndihmës gjyqësor, kushtet e dobëta të punës dhe infrastruktura, dështimi i palëve dhe dëshmitarëve për të marrë pjesë në seanca të gjykimit dhe problemet lidhur me ftesat për palët.⁸

Tre faktorë tjerë paraqesin pengesë në të drejtën për qasje në drejtësi. Së pari, rastet civile në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica dhe gjykatat komunale në Mitrovicë/Mitrovica, Leposavić/Leposaviq dhe Zubin Potok kanë ngecur për shkak se ato gjykata për momentin nuk janë duke funksionuar. Së dyti, Misioni i OSBE-së në Kosovë (OSBE) është i njohur lidhur me 18,000 rastet për të cilat Departamenti i Drejtësisë së UNMIK-ut ka urdhëruar që mos të procedohen. Këto raste përfshijnë padi për kompensim të dëmeve që ndërliken me pronat të cilat ishin dëmtuar pas hyrjes së forcave të Organizatës së Paktit Veri-atlantik (NATO) në Kosovë në vitin 1999.⁹ Për derisa këto raste janë pjesë e lëndëve të pakryera, ato nuk mund të konsiderohen si vonesa nga ana e gjykatave, pasi që gjykatësit nuk ishin lejuar që ti procedojnë ato. Megjithatë, ato përfshijnë konteste të pazgjithura në të cilat paditësi ka të drejtën për vendim final të marur nga organi adekuat gjyqësor. Së treti, më se 500 padi të shqiptarëve të Kosovës kundër Republikës së Serbisë dhe/ose Republikës Federative të Jugosllavisë për dëmet e shkaktuar gjatë konfliktit mbeten të pezulluara.

Paditë e pezulluara në bazë të instruksionit të Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut dhe ato kundër Republikës së Serbisë dhe/ose Republikës Federative të Jugosllavisë nuk duhet që më tej t'i kontribuojnë ngarkesës me lëndë sepse numri i tyre ka mbetur i pandryshuar. Megjithatë, menaxhimi i dobët i lëndëve, kushtet e punës dhe dështimi i palëve për të marrë pjesë në gjykime dhe mos-funksionimi i vazhdueshëm i gjykatave në Mitrovicë/Mitrovica, Leposavić/Leposaviq dhe Zubin Potok shërbejnë vetëm në rritjen e ngarkesës me lëndë. Andaj, fatkeqësisht OSBE beson se mund të pritët që ngarkesa e lëndëve civile në vitin 2008 vetëm të rritet krahasuar me vitin 2007.

2) Menaxhimi i dobët i lëndëve, dështimi i palëve, avokatëve dhe dëshmitarëve për të marrë pjesë në seanca të gjykimit, dhe problemet me fletëthirrje

Menaxhimi i dobët i lëndëve nga ana e gjykatave mund të shpjegohet si në vijim. Shpesh, gjykatat nuk vendosin afate kohore për të propozuar palët dëshmi dhe zhvillojnë procedurën pa plan për të prezantuar dëshmi në mënyrë logjike, që qon në vonesa në raste, që do të mund të shmangeshin.¹⁰ Një tjetër faktor kontribuues në këto

⁸ Mungesa ose shpërndarja jo e barabartë e gjyqtarëve gjithashtu i kontribuon vonesave. Shih Raportin Mujor i OSBE-së, *Numri i pamjaftueshëm ose shpërndarja jo e barabartë e gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe objektet e papërshtatshme të gjykatave mund të qojnë në shkelje të ligjit vendor dhe standardeve për të drejtat e njeriut*, shkurt 2008. Mungesa e një sistemi funksional elektronik për menaxhim të lëndëve në shumicën e gjykatave të Kosovës gjithashtu ndalon administrimin efektiv të lëndëve.

⁹ Departamenti i Drejtësisë, DOJ/JDD/449/lh/04, 26 gusht 2004.

¹⁰ Edhe pse Ligji mbi Procedurën Kontestimore nuk vendos afate kohore për prezantim të dëshmive, një numër i dispozitave vendosin obligim mbi paditësin që të prezantojë dëshmitë e propozuara (veçanërisht dokumentacione dëshmuese) së bashku me akt-padinë, ose së paku, në seancën përgatitore. Shih nenet 286(1) dhe 186(1) të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore. Andaj, gjykata duhet të kërkojë nga palët që të justifikojnë parashtrimin e vonuar të dëshmive. Duke pranuar gjatë seancave

vonesa është dështimi i paraqitjes së dëshmitarëve.¹¹ Rasti në vijim shërben si shembull:

Në një padi pranë një gjykate në regjionin Pejë/Peć e datës 18 shkurt 2004, paditësit serb të Kosovës kërkuan anulimin e transaksionit pronësor kinse ishte kryer në bazë të një autorizimi të falsifikuar. Në seancën e parë të datës 7 nëntor 2005, palët prezantuan dëshmi dhe propozuan dëgjimin e tre dëshmitarëve. Gjykata shtyu seancën e dytë (18 nëntor 2005) për shkak të mungesës së këtyre dëshmitarëve.¹² Po ashtu dëshmitarët nuk u paraqitën në katër seancat e ardhshme.¹³ Në seancën e gjashtë (2 mars 2006) i padituri propozoi që eksperti të ekzaminojë vlefshmërinë e dy kartelave të identitetit të lëshuara në emër të paditësit (njëra nga ato ishte përdorur në një transaksion pronësor).¹⁴ Gjykata dëgjoi dy dëshmitarë në seancën e shtatë (29 mars 2006). Gjykata shtyu seancën e tetë (17 dhjetor 2007) për shkak të mungesës së avokatit. Në seancën e nëntë (24 janar 2008), avokati i paditësit propozoi që ekzaminimi i ekspertit të vërtetojë autenticitetin e nënshkrimit në autorizimin e kontestuar dhe avokati i të paditurit propozoi dëgjimin e më shumë dëshmitarëve. Gjykata aprovoi dëgjimin e dëshmitarëve të cilët nuk u paraqiten në seancën e dhjetë dhe të njëmbëdhjetë (18 mars 2008 dhe 11 prill 2008). Në këtë seancë të fundit, paditësi kërkoi prapë që eksperti të verifikojë autenticitetin e nënshkrimit në autorizim. Rasti vazhdon ende.

OSBE është gjithashtu e brengosur për shkak të shtyrjeve të shumëfishta për shkak të dështimit të avokatëve për t'u paraqitur në seanca gjyqësore¹⁵ dhe paaftësinë ose dështimin e gjykatave për t'i ftuar të paditurit të cilët me gjasë jetojnë në adresë të panjohur.¹⁶

gjykuese një prezantim të paarsyeshëm dhe të vonshëm të dëshmimeve dhe duke mos kërkuar nga palët që këtë gjë ta bëjnë në fazë më të hershme të procedurës, gjykatat i kontribuojnë vonësive në procedura.

¹¹ Sipas Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, dëshmitarët janë të obliguar t'i përgjigjen ftesave të gjykatës. Në qoftë se një dëshmitarë i cili është ftuar në mënyrë të rregullt dështon ta paraqitet pa arsyetim, gjykata mund ta gjobitë atë bazuar në nenet 235 dhe 248 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

¹² Gjykata i ftoi dëshmitarët në mënyrë të rregullt, por ata nuk u paraqitën. Megjithatë, gjykata nuk vendosi kurrfarë gjobe siç është e lejuar me nenin 248 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

¹³ E datës 2 dhjetor 2005, 27 dhjetor 2005, 26 janar 2006 dhe 2 mars 2006. Nuk është e qartë se a i kishte ftuar gjykata dëshmitarët në këto dy seanca.

¹⁴ Megjithatë, gjykata aprovoi vetëm propozimin e të paditurit për të verifikuar faqen e parë të kartelave të identitetit nga autoritetet kompetente.

¹⁵ Sipas Odës së Avokatëve të Kosovës, Kodi i Etikës Profesionale të Avokatëve, 11 qershor 2005, neni 29, avokatët duhet të japin këshilla dhe të mbrojnë me përkushtim të duhur dhe dinjitet. Andaj, dështimi për t'u paraqitur në seancë gjyqësore pa justifikim përbën shkelje të Kodit të Etikës Profesionale të Avokatëve. Sipas nenit 295 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, gjykimi gjithashtu mund të mbahet në mungesë të palëve në qoftë se ata janë ftuar në mënyrë të rregullt. Veç kësaj, sipas nenit 332 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, gjykata mund të merr "aktgjykim për shkak të mungesës", në qoftë se i padituri (ose avokati i tij/saj nëse ai/ajo përfaqësohet nga avokati) dështon të paraqitet dhe plotësohen kushtet tjera.

¹⁶ Vlen të ceket se, paditësi duhet të shënoj adresën e të paditurit në fletë-padi. Shih nenin 106 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore. Megjithatë, "[n]ë qoftë se pala nuk mund të gjej adresën e personit të cilit duhet t'i dorëzohet fletëthirrja [...] gjykata do të tentojë të merr informatën e nevojshme nga organi kompetent administrativ, ose këtë informatë ta merr në ndonjë tjetër mënyrë." (Neni 186 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore). Veç kësaj, sipas nenit 84 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, gjykata nuk mund të caktojë përfaqësues të përkohshëm për të paditurin nëse vendndodhja e tij/saj është e panjohur. Shih gjithashtu Raportin Mujor të OSBE-, *Dështimi i gjykatave për të kontaktuar*

Në një rast pronësor të iniciuar pranë një gjykate në regjionin Mitrovicë/Mitrovica më 25 shtator 2006, që nga ajo kohë gjykata ka caktuar tetë seanca pa i diskutuar më parë rrethanat e rastit. Gjykata shtyu dy seancat e para¹⁷ për shkak të mungesës së njërit ose të dy avokatëve të paditësve dhe të paditurve serb të Kosovës të cilët me gjasë jetojnë në adresë të panjohur. Në seancën e tretë, të dy avokatët e paditësve morën pjesë por jo edhe të paditurit ose avokatët e tyre (pasi që të paditurit nuk ishin ftuar). Avokatët e paditësve kërkuan shtyrje për shkak se iu duheshin dokumente nga klientët e tyre. Në seancën e pestë¹⁸, paditësi propozoi që të caktohet përfaqësues i përkohshëm për të paditurit. Gjykata caktoi seancën e gjashtë për një ditë feste. Shtyu seancën e shtatë dhe të tetë¹⁹ për shkak të mungesës së njërit nga avokatët e paditësve.²⁰ Rasti ende vazhdon.

OSBE ka vërejtur vonesa serioze në rastet civile ku pala që duhet të ftohet banon jashtë Kosovës.²¹ Në rastet ku palët ose dëshmitarët banojnë jashtë Kosovës, Qarkorja e Drejtësisë 2003/03 Mbi Ndhimën Ligjore Ndërkombëtare në Çështjet Penale dhe Civile parasheh se dërgimi i fletëthirrjeve do të dorëzohet në formë të shkruar nga ana e gjykatës dhe do t'i adresohet Drejtorit të Departamentit të Drejtësisë.²²

Në një rast pranë një gjykate në regjionin Prishtinë/Priştina, të iniciuar më 18 dhjetor 2006, gjykata më 13 nëntor 2007 vendosi që përmes Departamentit të Drejtësisë ta ftojë të paditurin serb të Kosovës i cili banon jashtë Kosovës. Pasi që deri në seancën e radhës më 14 maj 2008, Departamenti i Drejtësisë nuk iu kishte përgjigjur kërkesës së gjykatës, gjykata ri-caktoi seancën për 3 dhjetor 2008.

3) Mos-funksionimi i gjykatave komunale dhe të qarkut në regjionin Mitrovicë/Mitrovica

Mos-funksionimi i gjykatave të qarkut dhe komunale në regjionin Mitrovicë/Mitrovica, që pas 17 shkurtit 2008 i ka kontribuar edhe më tej numrit të pakryer të lëndëve gjyqësore në rastet civile.²³ Që nga ajo kohë, paditësit nuk kanë

organin kompetent administrativ ose për të përdorur mjete alternative për t'i alokuar të paditurit shkel ligjin vendor e mbase edhe të drejtën për gjykim korrekt, prill 2008.

¹⁷ E datës 14 dhe 28 dhjetor 2007. Në seancën e datës 28 dhjetor, njëri nga avokatët nuk e arsyetoi mungesën e tij dhe avokati tjetër pohoi se ishte i zënë në një gjykim tjetër në po të njëjtën kohë.

¹⁸ E datës 3 mars 2008.

¹⁹ E datës 25 mars 2008 (avokati i paditësit pohoi se ka qenë i angazhuar në një tjetër gjykim në kohë të njëjtë) dhe e datës 12 maj 2008 (të dy avokatët dështuan të paraqiten pa ndonjë arsytim).

²⁰ Ndërkohë, një avokat u paraqit në gjykatë dhe paraqiti autorizimin për të përfaqësuar dy të paditurit. Ky avokat gjithashtu ishte nip i njërit prej avokatëve të paditësve.

²¹ Shih Raportin tremujor të OSBE-së (janar – mars 2007), III. B. *Vonesat në procedurat civile për shkak të problemeve rreth dërgimit të fletëthirrjeve gjyqësore për të paditurit që banojnë jashtë Kosovës.*

²² E lëshuar nga Departamenti i Drejtësisë më 5 shtator 2003. Kjo vlen si për kërkesa për Ndhimë Ligjore Ndërkombëtare ashtu edhe për ndihmën ligjore që ka të bëjë me Serbinë dhe Malin e Zi. Shih gjithashtu nenin 133, Ligji mbi Procedurën Kontestimore.

²³ Shih Raportin Mujor të OSBE-së, *Reagimet ndaj shpalljes së pavarësisë së Kosovës në ndikojnë seriozisht në sistemin e drejtësisë në Mitrovicë/Mitrovica dhe ndikojnë negativisht në gjykatat e regjioneve tjera, duke rezultuar me shkelje të të drejtave të njeriut*, mars 2008.

mundur të parashtrinë padi të reja civile ndërsa nuk ka pasur progres në rastet civile që janë në procedurë. Rasti në vazhdim shërben si shembull:

Në një rast pronësor pranë një gjykate në regjionin Mitrovicë/Mitrovica, një i paditur serb i Kosovës ka parashtruar një kërkesë për rigjykim më 4 prill 2005.²⁴ Shqyrtimi i kërkesës është bërë vetëm gati dy vite e gjysmë më vonë, me 6 nëntor 2007.²⁵ Pas kësaj seance kryetari i kolegjit tha se ai do t'i sjell vendimet e tij "brenda afateve të lejueshme ligjore."²⁶ Edhe pse gjykata me sa duket ka aprovuar kërkesën për rigjykim në po të njëjtën ditë²⁷, deri më sot nuk ka caktuar seancë për rigjykim. Rasti për momentin është ngujuar për shkak se gjykata në regjionin Mitrovicë/Mitrovica nuk ka funksionuar që nga shkurti 2008.²⁸

Kështu, në rastin e sipërpërmendur, gjykata ende nuk ka caktuar seanca gjyqësore për ri-gjykim për më shumë se tre vjet pas kërkesës fillestare.²⁹

4) Paditë nga Serbët e Kosovës për kompensim të dëmeve nuk procedohen sipas instruksionit të Departamentit të Drejtësisë brenda UNMIK-ut

OSBE është në dijeni së më shumë se 18,000 padi³⁰ të parashtruara nga serb të Kosovës për kompensim të dëmeve të pronës me gjasë të shkaktuar prej vitit 1999 kur forcat e NATO-s kishin hyrë në Kosovë, janë "të pezulluara" pas një letre të Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut, drejtuar kryetarit të Gjykatës Supreme, kryetarëve të gjykatave të qarkut dhe atyre komunale në Kosovë në gusht të vitit 2004.³¹ Shumica janë padi për kompensim kundër UNMIK-ut, KFOR-it, komunave dhe individëve. Departamenti i Drejtësisë e ka rishikuar pjesërisht këtë instruksion përmes një qarkoreje të drejtësisë të datës 15 nëntor 2005,³² dhe urdhëroi gjykatat që menjëherë t'i procedojnë paditë për dëme të shkaktuara nga persona fizik të identifikuar ose pas tetorit të vitit 2000. Megjithatë, deri më sot, gjykatat kanë proceduar vetëm disa raste bazuar në këtë instruksion të ri.³³

²⁴ Në gjykimin e parë, Gjykata Komunale në Mitrovicë/Mitrovica me vendimin e datës 20 janar 2004 konfirmoi se paditësi shqiptar i Kosovës është pronar i parcelës kontestuese. Gjykimi u mbajt pa prezencën apo dijeninë e të paditurit dhe gjykata kishte caktuar një përfaqësues të përkohshëm për të. Sipas të paditurës, ajo u njoftua lidhur me vendimin në mars 2005, kur ajo shkoi në kadastër dhe gjeti se paditësi ishte i regjistruar atje.

²⁵ Gjatë një bisede me OSBE-në, gjyqtari e arsyetoi vonesën të shkaktuar nga mbingarkesa e lëndëve.

²⁶ Megjithatë, Ligji mbi Procedurën Kontestimore nuk specifikon një afat të tillë.

²⁷ OSBE pranoi kopjen e vendimit vetëm më 9 janar 2008.

²⁸ Vlen të ceket se, në ndërkohë paditësi i kishte shitur parcelën kontestuese palës së tretë.

²⁹ Veç kësaj, një gjyqtar serb i Kosovës nuk paraqitet në ven të punës që nga 17 shkurti. Kjo gjithashtu i kontribuon vonesave për shkak se rastet e tij për momentin nuk procedohen. Shih Raportin Mujor të OSBE- Reagimet ndaj shpalljes së pavarësisë së Kosovës në ndikojnë seriozisht në sistemin e drejtësisë në Mitrovicë/Mitrovica dhe ndikojnë negativisht në gjykatat e regjioneve tjera, duke rezultuar me shkelje të të drejtave të njeriut, mars 2008.

³⁰ Sipas informatës nga Kreu i Zyrës Ndërlidhëse të Gjykatave në Gračanica/Graçanicë të dhënë OSBE-së në maj 2008.

³¹ Departamenti i Drejtësisë, DOJ/JDD/449/lh/04, 26 gusht 2004. Kjo letër i referohet dhe ka të bëjë me paditë e "paditësve Serb etnik".

³² Departamenti i Drejtësisë, DOJ/JDD/04562/ia/05, 15 nëntor 2005.

³³ Intervista me nga Kreun e Zyrës Ndërlidhëse të Gjykatave në Gračanica/Graçanicë, dhe me disa kryetarë të gjykatave komunale dhe të qarkut në Kosovë në maj 2008..

Paditë të ushtruara kundër UNMIK-ut ose KFOR-it, të cilët janë imun ndaj çfarëdo procesi gjyqësor sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/47 mbi Statusin, Privilegjet dhe Imunitetet e KFOR-it dhe UNMIK-ut dhe Personelit të Tyre në Kosovë, dhe të cilët bien jashtë mandatit të gjykatave, duhet të dallohen nga paditë e ushtruara kundër komunave të Kosovës ose personave individual. Përderisa ka bazë ligjore (siç është imuniteti) për të mos proceduar paditë kundër UNMIK-ut ose KFOR-it, nuk ka bazë të qartë ligjore për të mos lejuar padi për kompensim kundër komunave ose personave individual që nuk janë pjesë e KFOR-it ose UNMIK-ut.

Instrukcionet e Departamentit të Drejtësisë kanë penguar të drejtën për qasje në gjykata për paditë serb të Kosovës dhe mund të përbëjnë shkelje të së drejtës për të pasur rastin e gjykuar brenda kohës së arsyeshme.³⁴ Rrjedhimisht, këto padi duhet të shqyrtohen nga gjykatat ose të zgjidhen në ndonjë mënyrë që është në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

5) Paditë e Shqiptarëve të Kosovës kundër Republikës së Serbisë dhe/ose Republikës Federative të Jugosllavisë për dëmet e shkaktuara gjatë konfliktit

Aktualisht ka 544 padi të suspenduara të parashtruara nga shqiptarë të Kosovës kundër Republikës së Serbisë dhe/ose Republikës Federative të Jugosllavisë për dëmet me gjasë të shkaktuara gjatë konfliktit. Një gjykatë në regjionin Pejë/Peć, (ku të gjitha këto raste ishin iniciuar),³⁵ ka suspenduar këto raste në bazë të nenit 215 paragrafi 3 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, “(pasi që marrëdhëniet ligjore në mes të padituri të parë dhe të dytë [Republika e Serbisë dhe Republika Federative e Jugosllavisë] dhe Kosovës e cila ende ndodhet nën administrim të përkohshëm të Kombeve të Bashkuara, akoma nuk janë rregulluar, [është e pamundur për gjykatën të zgjidh këtë kontest]”).³⁶ Përpos 544 rasteve, gjykata nuk i ka suspenduar në mënyrë zyrtare 716 raste tjera, por edhe nuk i ka proceduar ato.³⁷ Kjo ngrit çështje të përgjegjësisë shtetërore kundrejt dëmeve të shkaktuara ndaj individëve. Duke pasur parasysh se të gjitha palët në konflikt janë përballë me dëme të pronës, duhet të gjendet një zgjidhje për këto raste.

³⁴ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në disa raste ka nënvizuar se e drejta për qasje në gjykata është pjesë e së drejtës për gjykim korrekt dhe duhet të bëhet efektive. Shih Gjykata Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aplikacioni nr. 4451/70, aktgjykimi, 21 shkurt 1975, paragrafi 25. Edhe pse nën rrethana të caktuara autoritetet mund të vendosin restriksione lidhur me ushtrimin e kësaj të drejte, ‘margjina e vlerësimit’ në dispozicion të tyre nuk do të qoj në kufizime që do të dëmtojë esencën e së drejtës. Shih Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Ashingdane kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aplikacioni nr. 8225/78, aktgjykimi, 28 maj 1985, paragrafi 57. Gjithashtu, çfarëdo restriksione duhet të kenë “qëllim legjitim” dhe të jenë në përputhje me parimin e proporcionalitetit, që do të thotë se duhet të ketë “marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet.” *Ibidem*. Andaj, këto kërkesa, arsyet për suspendimin e këtyre rasteve janë të debatueshme. Kjo çështje ngriti shqetësimet brenda Institutit të Ombudspersonit në Kosovë, i cili adresoi çështjen të Departamenti i Drejtësisë në disa raste. Shih Instituti i Ombudspersonit në Kosovë, *Raporti i Pestë Vjetor 2004-2005 i adresuar Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara*, 11 korrik 2005, e qasshme në <http://www.ombudspersonkosovo.org>.

³⁵ Sipas informatës nga kreu i zyrës për statistika të Këshilli Gjyqësor të Kosovës dhënë OSBE-së në maj 2008.

³⁶ Shih vendimin e gjykatës të datës 9 tetor 2002 në një rast të një shqiptari të Kosovës kundër Republikës së Serbisë dhe Republikës Federative të Jugosllavisë.

³⁷ Informata nga kryetari i një gjykate në regjionin Pejë/Peć dhënë OSBE-së në maj 2008.

6) Rekomandime

Pozicioni i OSBE-së është se:

- Gjyqtarët duhet të shfrytëzojnë të gjitha mjetet në dispozicion për të siguruar që gjykimet të përfundojnë pa vonesa të panevojshme, siç janë gjrobat për dëshmitaret të cilët nuk vijnë.
- Rekomandohet që Instituti Gjyqësor i Kosovës t'i trajnojë gjyqtarët mbi menaxhimin efikas të lëndëve.
- Avokatët duhet t'i përfaqësojnë klientët me dinjitet dhe të mos i kontribuojnë vonesave në procedura gjyqësore.
- Departamenti i Drejtësisë duhet t'i intensifikojë përpjekjet lidhur me ftesa të palëve që banojnë jashtë Kosovës.
- Mosfunksionimi i gjykatave në regjionin Mitrovicë/Mitrovica duhet të zgjidhet.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Departamenti i Drejtësisë duhet të krijojnë një plan për t'i zgjidhur më shumë se 18,000 padi nga serbët e Kosovës kundër UNMIK-ut, KFOR-it, dhe komunave të cilat nuk janë proceduar në bazë të instruksionit të Departamentit të Drejtësisë.
- Duhet të zgjidhet numri prej përafërsisht 1,200 padive nga shqiptarët e Kosovës kundër Republikës së Serbisë dhe/ose Republikës Federative të Jugosllavisë për dëmet gjatë konfliktit të vitit 1999.